



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORE E EKIPEVE KOMBËTARE TË KOSOVËS NË HENDBOLL

Ne baze te nenit 21 pika 1 te Statutit te Federatës se Hendbollit te Kosovës, Bordi i FHK-se ne mbledhjen e vet te mbajtur me 01.10.2022 ne Prishtine aprovoi:

RREGULLORE E EKIPEVE KOMBËTARE TË KOSOVËS NË HENDBOLL

I. DISPOZITAT THEMELORE

- 1.1. Me Rregulloren e Ekipeve Kombëtare të Kosovës (ne tekstin e mëtejme: Rregullorja), përcaktohen:
 - Kategoritë dhe emërtimet e Kombëtareve.
 - Obligimet e klubeve përballë Kombëtareve.
 - Obligimet e hendbollisteve/hendbollistëve përballë Kombëtares.
 - Drejtori, përzgjedhësit dhe shtabet profesionale te Kombëtareve.
 - Delegacioni i Federatës se Hendbollit te Kosovës dhe udhëheqësit e rrugës te Kombëtareve.
 - Kadi i Sjelljes ne Kombëtare shtetërore
- 1.2. Kombëtares e Hendbollit përfaqësojnë Republikën e Kosovës, Federatën e Hendbollit Kosovës (ne tekstin e mëtejme: FHK) dhe sportin kosovar ne garat dhe paraqitjet ndërkombëtare.
- 1.3. Te qenit pjese e Kombëtareve te Kosovës ne hendboll është nder dhe obligim i secilit hendbollist dhe hendbolliste, secilit anëtar te shtabit profesional, si dhe te çdo anëtar tjetër te FHK-se.
- 1.4. Është obligim i secilit anëtar te FHK-se qe te siguroj kushte optimale për pune dhe suksese te Kombëtareve. Suksesi i Kombëtareve është prioritet për Federatën e Hendbollit të Kosovës, ne veçanti kur behet fjale për kalendarin e garave zyrtare te IHF dhe EHF.
- 1.5. Me emërtimin kombëtare nënkuptohet:
 - Kombëtarja A e Meshkujve.
 - Kombëtarja A e Femrave.
 - Kombëtarja U21 e Meshkujve
 - Kombëtarja U20 e Meshkujve.
 - Kombëtarja U19 e Femrave.
 - Kombëtarja U18 e Meshkujve.
 - Kombëtarja U17 e Femrave.

- Kombëtarja U16 e Meshkujve.
- Kombëtarja U15 e Femrave.

FHK sipas nevojës mund të krijoj edhe Kombëtare të tjera (U14, U12, mesdhetare, studentore, ushtarake, policore etj), por asesi klubi, apo ndonjë klub i qytetit apo regjionit nuk mund të emërtoj veten Kombëtare dhe të garoj me këtë emër.

- 1.6. Ngjyrat e fanellave dhe veshmbathjeve të tjera sportive të Kombëtares janë kaltër, bardhe dhe e hirit në përputhje me brendin e FHK i miratuar nga kunvendi i FHK-së .

Stema shtetërore e Republikës së Kosovës, logo e FHK-se dhe logo e EHF (apo IHF) vendosen sipas manualit të EHF (apo IHF kur bëhet fjalë për ngjarje globale).

- 1.7. Kombëtaren e përbejnë lojtaret e përzgjedhur, përzgjedhësi, Drejtori dhe anëtarët e shtabit Profesional, përgjegjësi për informim i federatës si dhe gjyqtari në rast se delegohet nga EHF.

- 1.7.1. Në rast se drejtori e sheh të arsyeshme, në kombëtare mund të jetë edhe ekonomi, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarit të ekipit kombëtar.

- 1.7.2. Në rast se gjyqtari është anëtarë i Kombëtares, sipas alinesë paraprake të këtij neni, ka të drejta dhe obligime të ngjashme sikur të anëtarëve të Kombëtares (shpenzimet e transportit dhe akomodimit).

- 1.8. Gjyqtaret për turne dhe ndeshjet miqësore i delegon Komisari i garave në baze të propozimit të Shoqatës së Gjyqtareve të Hendbollit të Kosovës, përpos në rastet kur ata i delegon EHF.

II. OBLIGIMET E KLUBEVE

- 2.1. Është obligim i çdo klubi, amator apo profesional, që për zbatimin e programit të aktiviteteve të Kombëtareve, të vë në dispozicion të FHK-së të gjithë lojtaret e përzgjedhur si dhe tërë potencialin profesional dhe potencialin tjetër në arritjen e sukseseve të Kombëtares.
- 2.2. Sistemi i garave në të gjitha garat e FHK-se do të përgatitet dhe miratohet në koordinim të plotë me kalendarin e garave zyrtare të EHF-së në interes të Kombëtareve të Kosovës.

- 
- 2.3. Obligim i secilit klub, amator apo profesionale është qe ti përmbahet kalendarit te miratuar, të cilin e ka miratuar Bordi i FHK-se.
- 2.4. Anëtarit (hendbollistit/es, trajnerit/es, mjekut, fizioterapeutit, ekonomit etj) te përzgjedhur ne Kombëtare , është i obliguar qe ti mundësoj pjesëmarrjen ne programin, duke përfshire, përgatitjet, ndeshjet miqësore dhe garat e Kombëtareve.
- 2.5. Klubi përgjatë kohës qe lojtari, trajneri, mjeku, fizioterapeuti, ekonomi etj janë te angazhuar ne Kombëtare, nuk ka te drejte te mos e paguaje për arsyen se ka qene i angazhuar ne Kombëtare.
- 2.6. Nëse paraqitja zyrtare e klubit përputhet me obligimet e Kombëtare ne te cilën është zgjedhur, lojtari i atij klubi qe ka te drejte te kërkoj shtyrjen e ndeshjes se vet (për kupe apo kampionat) dhe atë për tërë kohën sa lojtari është me Kombëtaren. Lojtarët te përzgjedhur ne Kombëtare nuk i lejohet qe ne kohen e aktiviteteve te Kombëtareve te luaj neper turne me klubin e vet, përpos ne raste kur ketë e lejon Drejtori i Kombëtareve.
- 2.7. Nëse për mospjesëmarrjen apo vonesën e lojtareve ose te ndonjë tjetër anëtarit te Kombëtare ne grumbullimet e Kombëtare përgjegjës është klubi, atëherë do te dënohet klubi ne shumen prej 1000 € deri ne 5000 €, e nëse vërtetohet se kjo është bere ekskluzivisht me fajin klubi. Ndaj këtij klubi mund te merren edhe masat me te rrepta disiplinore konform akteve normative te FHK-se.
- 2.8. Gjate garave zyrtare te kalendarit te EHF-s ne rast se klubi e ndalon lojtarin për te mos u paraqitur ne Kombëtare, klubi ne fjale do te ndëshkohet komfor akteve normative ne fuqi te FHK-se dhe EHF e IHF.

III. OBLIGIMET E TRAJNEREVE TE KLUBEVE

- 3.1. Trajneri i klubit te caktuar nga i cili është i ftuar lojtari i asaj skuadre për Kombëtare – trajneri i skuadrës nga i cili vjen lojtari i ftuar duhet qe te ketë bashkëpunim me Përzgjedhësin e Kombëtareve:
- te realizoj plan-programin kur e kërkon Përzgjedhësi,
 - te kryej stërvitje shtese me lojtarin e Kombëtares kur atë e kërkon Përzgjedhësi,
 - mos t'i behet pengese lojtarit qe te shkoj ne stërvitje me Kombëtaren.

- 3.1.1. Ne rast te mos përmbajtjes se kësaj Rregulloreje pason dënimi për trajnerin e skuadrës ne fjale nga minimumi 6 deri 12 muaj moskryerje te detyrës si trajner i skuadrës dhe nga 200 deri 500€ dënim ne te holla.

IV. OBLIGIMET E LOJTARËVE

- 4.1. Për Kombëtaren e Kosovës mund te angazhohen shtetasit e Kosovës dhe lojtaret me dyshtetësi komfor rregulloreve te Federatës Ndërkombëtare te Hendbollit (IHF).
- 4.2. Pjese e Kombëtares nuk mund te jete lojtari i suspenduar, i dënuar ose qe kundër tij zhvillohet procedure disiplinore. Ne raste te veçanta, me kërkesën e përzgjedhësit, organi i cili zhvillon procedurën disiplinore, mund ta heq suspendimin, gjegjësisht, ta shtyj procedurën disiplinore.
- 4.3. Lojtari i Kombëtares se Kosovës është i obliguar ta përfaqësoj Kosovën dhe hendbollin e Kosovës ne garat ndërkombëtare. Lojtari i Kombëtares se Kosovës është i obliguar te kontribuoj me tere dijen dhe angazhimin e vet maksimal për arritjen e rezultateve sa me te mira te Kombëtares, dhe te aplikoj rregullat e Hendbollit dhe rregullat e "FAIR-PLAY", si dhe duhet te jete shembull me sjelljet e tij te mira brenda dhe jashtë fushës se lojës.
- 4.4. Në përgatitjet dhe ndeshjet e Kombëtareve te Kosovës, lojtari i përzgjedhur është i obliguar t'u përmbahet udhëzimeve dhe urdhëresave për stërvitje, ndeshje, qëndrimin ne përgatitje, udhëzimeve për shfrytëzimin e pajisjeve, udhëzimeve për ushqim dhe barna (sipas listës së WADA), si dhe udhëzimeve te tjera te cilat i parashtrohet shtabi teknik dhe përzgjedhësi i Kombëtares.
- 4.5. Pas përcaktimit te listës se lojtarëve (lojtareve) si kandidat te ndonjëres Kombëtares, Drejtori i Kombëtares, me shkrese fton lojtaret e përzgjedhur për bashkëpjesëmarrje ne punën e Kombëtares. Ftesa i dorëzohet lojtarit, klubit, apo edhe federatës, ne garat e te cilës merr pjese dhe komfor afateve te përcaktuara nga IHF dhe EHF . Ftesa duhet te behet nëpërmjet adresës zyrtare te FHK-se.
- 4.6. Ftesa për lojtarin përmban programin e përgatitjeve dhe ndeshjeve, kohen dhe vendin e grumbullimit, si dhe obligimet e lojtarit.

- 
- 4.7. Lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për përgatitje dhe ndeshje te Kombëtares. Me marrjen e ftesës për pjesëmarrje ne Kombëtare krijohen obligimet për lojtarin dhe klubin e tij.
- 4.8. Abstenimi për pjesëmarrje ne Kombëtareve mund te behet vetëm me arsye dhe dëshmi. Shkaqe te arsyeshme konsiderohen:
- rastet e vdekjes ose sëmundjes se rende ne familje,
 - lëndimi i rënde ose sëmundja e lojtarit. Shkallen e lëndimit ose te sëmundjes se lojtarit e përcakton mjeku i Kombëtares ose Komisioni Mjekësor i caktuar nga FHK.
- 4.9. Në rast te abstenimit, lojtari i ftuar është i obliguar qe me shkrim ta njoftoj përzgjedhësin përmes Drejtorit te Kombëtareve. Abstenimin me shkrim, ne afat prej 48 orësh nga pranimi i Ftesës mund ta paraqes edhe klubi ne vend te lojtarit.
- 4.10. Nëse rrethanat për abstenim krijohen pas marrjes se ftesës, lojtari, gjegjësisht klubi janë te obliguar qe me shkrim menjëherë ta njoftojnë përzgjedhësin përmes Drejtorit te Kombëtares.
- 4.11. Lojtari i cili abstenon nga pjesëmarrja ne Kombëtares për shkak te lëndimit ose sëmundjes, është i obliguar qe ketë ta paraqesë me shkrim, kurse bashke me shkresën duhet te paraqesë tere dokumentacionin mjekësor lidhur me lëndimin ose sëmundjen e tij. Nëse mjeku ose Komisioni Mjekësor i Kombëtares vlerësojnë se lojtari duhet kontrolluar nga ana e tyre, lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për kontrollim te mëtejme. Ne rast se lojtari nuk i përgjigjet ftesës për kontroll te mëtejme, do te konsiderohet se mungesa e tij është e paarsyeshme.
- 4.12. Ndaj lojtarit i cili pa arsye vonohet ose nuk i përgjigjet ftesës për grumbullim, ose qe gjate përgatitjeve me veprimet e tij dëmton autoritetin dhe imazhin e Kombëtares, do te iniciohet procedure disiplinore ne Komisionin Disiplinor te FHK-se. Ne raste te dyshimit te bazuar për kundërvajtje për te cilën me Rregullore Disiplinore te FHK-se parashihet dënimi me mos lojë deri ne një vit, përzgjedhësi i Kombëtares, duke iniciuar procedure disiplinore, propozon pezullimin e lojtarit.
- 4.13. Ne rast te shqiptimit te masës se pezullimit, ne baze te Rregullores Disiplinore te FHK-se, lojtari i pezulluar nuk ka te drejte loje për Kombëtaren

e as për klubin e tij, gjate tere kohës se pezullimit.

- 4.14. Përpos dënimit me mos-loje, për kundërvajtjen e vonesës se paarsyeshme, mos përgjigjes për grumbullim dhe paraqitje ne Kombëtare, lojtari mund te dënohet me ndalesë të lojës deri në 3 muaj deri në dy vite dhe me gjobë me te holla prej 200 deri ne 3000 € . Ne rast te mos pagesës se dënimit me te holla nga ana e lojtarit, Komisari i Garave mund t'i shqiptoj ndalesën me mos lojë te lojtarit, derisa te paguhet dënimi i shqiptuar.
- 4.15. Për masën e pezullimit, masën e ndalesës për loje ose dënimin me te holla njoftohet zyra e EHF-së, nëse ketë e vlerëson te nevojshme Sekretari i Përgjithshëm i FHK-së, par patjetër kur është ne pyetje lojtari qe luan për ndonjë klub jashtë vendit, ose është duke realizuar te drejtën e kalimit ne një klub jashtë vendit.
- 4.16. Për fazën përgatitore dhe për ndeshje, lojtarit i takon kompensimi për shpenzime te rrugës, shpenzimet e qëndrimit, dhe kompensimi ditor ne lartësi te përcaktuar me vendimin e Bordit te FHK-se.
- 4.17. FHK siguron pajisjen sportive për secilën Kombëtare për lojtaret, përzgjedhësin dhe shtabin profesional te Kombëtares. Te gjithë anëtarët e Kombëtares janë te obliguar ti mbajnë pajisjet gjate tere kohës se aktivitetit te Kombëtares, te cilat i përcakton dhe i siguron FHK.
- 4.18. Lojtari e ka rreptësishtë të ndaluar që gjatë gjithë kohës së grumbullimit të paraqitet me pajisje që nuk i kanë shenjat identifikuese të Kombëtares së Kosovës. Pra gjatë qëndrimit në hotel apo kamp, gjatë stërvitjeve, rrugës për në stërvitje, kohës së lirë, rrugës për në ndeshje apo aktivitete, lojtarët duhet të kenë veshjet e Kombëtares së Kosovës dhe nuk lejohen me veshje të klubeve të tyre apo veshje të tjera, aq më pak të ekipeve tjera kombëtare.
- 4.19. Lojtarët janë të obliguar të ruajnë pajisjet sportive që i marrin në fillim të grumbullimit dhe t'i kthejnë ato te ekonomi në fund të çdo grumbullimi, pos në rastet kur drejtori i ekipit kombëtar vendos që pajisjet t'u falen lojtarëve.
- 4.20. Lojtarët e kanë të ndaluar të konsumojnë duhan apo alkool gjatë grumbullimit. Nëse vërtetohet se kanë bërë një shkelje të tillë, lojtari mund të largohet nga grumbullimi dhe të gjobitet me gjobë prej 500 deri në 1500

euro. Drejtori apo përzgjedhësi mund të kërkojë masa shtesë për një shkelje të tillë të Komisioni Disiplinor.

- 4.21. Lojtareve, përzgjedhësit dhe shtabit profesional mund ti ndahen mirënjohe dhe shpërblime monetare, për rezultatet e arritura në gara. Lartësinë e shpërblimit e përcakton Bordi i FHK-se, kurse shpërblimet individuale i propozon përzgjedhësi. Bordi i FHK-se mund të vendos të shpërblejë me të holla edhe persona të tjerë për të cilët vlerësohet se janë meritues për suksesin e Kombëtares.

V. DREJTORI, PERZGJEDHËSIT DHE SHTABET PROFESIONALE TË PERFAQESUESËVE TË PERFAQESUESËVE TË REJA

- 5.1. Drejtorin e Kombëtares e emëron dhe e shkarkon Bordi i FHK-se. Drejtori mund të emërohet për ndonjë aktivitet kampionat apo për një periudhë kohore cikël. Periudha kohore mund të zgjat me se shumti 4 vite me të drejtë rizgjedhje pa kufizim.
- 5.2. Drejtori i Kombëtares është përgjegjës për të gjitha çështjet organizative, financiare dhe teknike të Kombëtareve.
- 5.3. Drejtori bashkëpunon ngushtë me Sekretarin e Përgjithshëm të FHK-se dhe përgjegjësin e federatës për komunikim. Për punën e tij, drejtori i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Bordit të FHK-se.
- 5.4. Në rast nevojë Drejtori mund të kërkojë që Bordi të emëroj zëvendës drejtor të Kombëtareve për femra dhe Kombëtares për të rinj.
- 5.5. Me vendimin e Bordit të FHK-se për emërimin e përzgjedhësit përcaktohet edhe statusi juridiko-punues i drejtorit, gjegjësisht përcaktohet nëse me Drejtorin do të behet kontratë për punë në kohë të caktuar apo kontratë mbi vepër.
- Drejtori duhet të ketë:
- njohje në hendboll si lojtar ose si trajner ;
 - të ketë aftësi organizative dhe të marketingut;
 - të flasë së paku një gjuhë zyrtare të EHF .
 - Përgjegjësitë e Drejtorit të Kombëtares të Kosovës do të përshkruhen në detaje në kontratën e përgatitur nga Sekretari i FHK-se.

- 5.6. Secila Kombëtare nga pika 4 e kësaj rregulloreje ka përzgjedhësin të cilin e emëron Bordi i FHK-se me propozim të Këshillit Profesional dhe në bashkëpunim me Drejtorin e Kombëtares dhe Drejtorin Teknik të FHK-se.
- 5.7. Statusi, të drejtat dhe detyrat e përzgjedhësit, me për se afërmi përcaktohen me kontratë pune për periudhën e caktuar, për të cilën emërohen nga Bordi i FHK-se.
- 5.8. Përzgjedhësi emërohet për ndonjë aktivitet të Kombëtares, kualifikime, gara ose për ndonjë periudhë kohore-cikel.
- 5.9. Me vendimin e Bordit të FHK-se për emërimin e përzgjedhësit përcaktohet edhe statusi juridiko-punues i përzgjedhësit, gjegjësisht përcaktohet se me përzgjedhësin do të nënshkruhet kontratë mbi vepër, do të thotë për periudhën kohore që ai do të kryej punën në detyrën e përzgjedhësit.
- 5.10. Në kontratën mbi vepër do të precizohet periudha për kohën sa përzgjedhësi do të paguhet nga FHK, për formën e pagesës dhe të gjitha detajet tjera financiare.
- 5.11. Me rastin e emërimit të përzgjedhësve të Kombëtareve, secili prej tyre në afat kohor prej një muaji që nga data e emërimit do të dorëzojë planin e punës për kombëtaren që është emëruar.
- 5.12. Plani i punës duhet të dorëzohet tek Këshilli profesional, ndërsa është Drejtori i Kombëtareve, i cili së bashku me Këshillin profesional e mbikëqyr punën e përzgjedhësit dhe programin e punës së tij.
- 5.13. Drejtori i Kombëtareve dhe Këshilli Profesional në baza javore e mujore e informojnë Sekretarin e përgjithshëm për ecurinë e planit të punës të përzgjedhësit.
- 5.14. Listën e gjere për çdo kombëtare e përcakton përzgjedhësi i kombëtareve nën mbikëqyrjen nga Këshilli profesional dhe Drejtorit të Kombëtareve.
- 5.15. Me të përfunduar aktiviteti i kombëtares, përzgjedhësi është i obliguar edhe me kontratë mbi vepër të raportojë tek Bordi i FHK-se. Nëse përzgjedhësi nuk e dorëzon raportin tek Bordi, atëherë Bordi do t'i referohet nënve të

kontratës, ne te cilat janë të precizuara ndëshkimet në rast të mos-përmbushjes së detyrave.

5.16. Përzgjedhësit dhe shtabet profesionale të Kombëtares janë të obliguara t'i përmbahen Statutit të FHK-se, kësaj Rregulloreje, Rregullores së Punës të Këshillit Profesional dhe akteve tjera të përgjithshme të FHK-se.

5.17. Përzgjedhësit kryejnë këto punë:

- Bashkëpunojnë në hartimin e planit të punës të aktivitetit të Kombëtareve.
- Përcaktojnë planin e aktiviteteve konkrete të Kombëtares.
- Propozojnë listën e gjere të kandidatëve për çdo aktivitet dhe gar.
- Përcaktojnë listën e ngushte të anëtarëve të Kombëtares për çdo aktivitet dhe gare.
- Në mënyrë profesionale udhëheqin stërvitjet dhe ndeshjet e Kombëtares.
- Përgatisin plane dhe programe individuale për punë të anëtarëve të Kombëtareve nëpër klube dhe mbikëqyrin realizimin e tyre.
- Përcjellin përparimin ose zhvillimin e hendbollistëve të rinj, kandidat potencial.
- Marrin pjesë në punën e Këshillit Profesional kur është e nevojshme.
- Paraqesin raport me shkrim për përgatitjet dhe ndeshjet në afat prej 30 ditësh, pas përfundimit të përgatitjeve apo aktiviteteve dhe garave të mbajtura.
- Se bashku me ndihmësit e tyre dhe i raportojnë për punën e tyre Këshillit Profesional dhe Drejtorit të Kombëtareve të Kosovës.
- Marrin pjesë në takime të ftuara nga Bordi i FHK-se, dhe trupave të tjera të FHK-se kur shqyrtohen tema profesionale me interes për Kombëtaren.

VI. PERZGJEDHESI I PERFAQESUESES A (SENIOR E SENIORE)

6.1. Përzgjedhësi i Kombëtares A (senior) të meshkujt dhe ai të femrave emërohen nga Bordi i FHK-se për periudhën të cilën ia cakton ky Bord.

6.2. Për përzgjedhës të Kombëtares të meshkujve dhe femrave mund të përzgjidhet personi që përpos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- Te ketë titullin e trajnerit te larte te hendbollit sipas Rinck Conventës Master Coach;
- Te ketë rezultate te larta me klub cilësisë se larte;
- Te flasë njëërën nga gjuhët zyrtare te EHF-se.

6.3. Përzgjedhësi i Kombëtares A te meshkujve dhe femrave mund te shkarkohet nga detyra edhe para skadimit te afatit kohor qe është paraparë në kontratë:

- Nëse për shkak te jo efikasitetit te realizimit te Planit te Punës kane munguar rezultatet e pritura;
- Nëse me veprimet e veta dëmton autoritetin dhe imazhin e Hendbollit kosovar, FHK-se e autoritetin e Republikës se Kosovës
- Për shkaqe te parapara me ligj ose kontrate ne mes te përzgjedhësit dhe FHK-se.

6.4. Ne rast te shkarkimit nga detyra e përzgjedhësit, te dorëheqjes ose ne raste te tjera, Bordi i FHK-se me propozimin e Këshillit Profesional emëron ushtruesin e detyrës ose përzgjedhësin e ri te Kombëtares se meshkujve dhe femrave ne konkurrencën e senioreve.

VII. PERZGJEDHESIT E KOMBËTAREVE TJERA

7.1. Te gjithë Përzgjedhësit e Kombëtareve te tjera sipas nenit 4 te kësaj Rregullore i emëron Bordi i FHK-se me propozim te Këshillit Profesional.

7.1.1. Përzgjedhësit duhet te jene:

- Trajner i licencuar ne FHK ;
- Te jete i dëshmuar me sukses ne kategorinë gjegjëse;
- Te jete trajner me kualifikime te larta apo me shkollim sipas programit të EHF te pranuar sipas RINCK Konventës
- Te njohë se paku një gjuhë zyrtare te EHF dhe IFH;

7.1.2. Përzgjedhësi mund te shkarkohet nga detyra edhe para skadimit te afatit kohor qe është në kontratë:

- Nëse për shkak te jo efikasitetit te realizimit te Planit te punës kane munguar rezultatet e pritura;
- Nëse me veprimet e veta dëmton autoritetin dhe imazhin e Hendbollit kosovar, FHK-se dhe autoritetin e Republikës se Kosovës;

- Për shkaqe të parapara me ligj ose kontratë në mes të përzgjedhësit dhe FHK-se.

- 7.2. Secili përzgjedhës, lojtar dhe anëtar i ekipit kombëtar duhet t'u përmbahet qëndrimeve të FHK-së për temat që kanë të bëjnë me sportin dhe zhvillimin e tij, por edhe për temat që direkt apo indirekt kanë ndikim në autoritetin dhe imazhin e FHK-së, dhe atë: në deklaratimet për media, në postime në rrjete sociale (duke përfshirë edhe profilet individuale), në komentimet që i bëjnë në postime të palëve të treta në rrjete sociale, në fjalime të ndryshme publike.
- 7.3. Për ndeshjet, aktivitetet, rezultatet, paraqitjet, në emër të ekipeve kombëtare flasin përzgjedhësi, kapiteni dhe lojtarët. Secila deklaratë për media duhet të bëhet në koordinim me përgjegjës për informim, drejtorin e ekipeve kombëtare dhe udhëheqësin e rrugës (në mungesë të përgjegjës për informim dhe drejtorit).
- 7.4. Secili anëtar i ekipit kombëtar ka përgjegjësi individuale për atë që deklaron.

VIII. SHTABET PROFESIONALE TE PERFAQESUESESEVE SHETERORE

- 8.1. Përpos përzgjedhësit të Kombëtares nga pika 4 e kësaj Rregulloreje, formohet Shtabi Profesional në të cilin bën pjesë një ose më shumë trajnerë, trajneri kondicional, mjeku dhe fizioterapeuti. Përzgjedhësi i Kombëtares mund të kërkojë nga Drejtori i Kombëtareve që ti sigurohet bashkëpunëtor-trajneri.
- 8.2. Anëtarët e Shtabit Profesional i emëron Bordi i FHK-se me propozimin e përzgjedhësit, mjekun dhe fizioterapeutin i emëron Drejtori i Kombëtares me rekomandimin paraprak të Komisionit Shëndetësor që vepron në kuadër të FHK-së.
- 8.3. Trajnerët dhe fizioterapeutët e Kombëtares bashkëpunojnë në punën e Kombëtares prej momentit të grumbullimit deri në përfundim të çfarëdo aktiviteti apo gare.
- 8.4. Mjeket e Kombëtares bashkëveprojnë në punën me Kombëtaren prej fillimit të grumbullimit ose sipas nevojës, kurse me Kombëtaren A senior të

meshkujve dhe femrave veprojnë prej momentit të grumbullimit të ekipit për aktivitet të veçante gjegjësisht gare të veçante.

- 8.5. Mjeket dhe fizioterapeutet e Kombëtares bashkëpunojnë me mjeket dhe fizioterapeutet e klubeve, mbikëqyrin gjendjen shëndetësore dhe propozojnë trajtim shëndetësor të kandidatëve për Kombëtaren, si dhe mbajnë evidencën shëndetësore të tyre.
- 8.6. Përzgjedhësi ose anëtari i shtabit profesional i cili gjatë punës me Kombëtareve me veprimet e veta dëmton autoritetin dhe imazhin e FHK-se ose hendbollit, përveç dënimit kohor të kryerjes së detyrës në kohëzgjatje prej një viti, dënohet edhe me të holla në shumën prej 2000 deri në 5000 €. Ndaj përzgjedhësit ose anëtarit të Shtabit Profesional Bordi i FHK-së inicion procedurë disiplinore për dëmtimin e autoritetit dhe imazhit të FHK-së, ose Hendbollit kosovar në tërësi.
- 8.7. Përzgjedhësve dhe anëtareve të shtabeve profesionale u takojnë kompensimet për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit dhe kompensimet ditore në lartësi të përcaktuar me vendimin e Bordit të FHK-se.

IX. DELEGACIONI I FEDERATES SE HENDBOLLIT TE KOSOVES DHE UDHEHEQESI I DELEGACIONIT

- 9.1. Pjesë përbërëse e secilit delegacion të Kombëtares duhet të jetë udhëheqësi i delegacionit (konform rregullave të EHF-së), të cilin e emëron Bordi i FHK-se me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm. Udhëheqësi i delegacionit duhet të përmbahet në përpikëri udhëzuesit dhe Kodit të Etikës të EHF.
- 9.2. Udhëheqësi i delegacionit është përgjegjës për Kombëtaren prej fillimit e deri në përfundim të aktivitetit. Udhëheqësve të delegacioneve u takojnë kompensimet për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit dhe kompensimet ditore në lartësi të përcaktuar me vendimin e Bordit të FHK-se.

X. SIGURIMI I ANETAREVE TE KOMBËTAREVE

- 10.1. Lojtarët, përzgjedhësit dhe anëtarët e shtabeve profesionale gjatë kohës së përgatitjeve ose të garave të Kombëtareve të Reja në rast se lëndohen, FHK i merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të tyre.
- 10.2. Lojtarët e Kombëtares A gjatë garave zyrtare të EHF e kanë të mbuluar sigurimin në momentin e hapjes së Dritareve në kuadër të garave kualifikuese, apo para kualifikuese për Kampionat Botëror .

XI. DISPOZITAT E PERGJITHSHËME

- 11.1. **Bordi i FHK-se përmes udhëzimeve përcakton:**
- 11.1.1. Standardet për të gjitha Kombëtarët, për numrin e lojtarëve, shtabet profesionale, numrin e anëtarëve të Kombëtareve, numrin e ditëve për përgatitje, vendosjen, stërvitjet, transportin, llojin e pajisjeve sportive, etj. Bordit udhëzimet ia propozon Drejtori i Kombëtareve në bashkëpunimin me Sekretarin e Përgjithshëm.
- 11.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje behën në mënyrë dhe procedure sikur me rastin e miratimit të saj.
- 11.3. Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bën Bordi i FHK-se.
- 11.4. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Eugen Saraçini

President

